



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2021:247986

Datë: 20.01.2022

Numri i dokumentit: 02627915

**PPP.nr.47/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbartimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit F.. SH.P.K me nr. te biznesit ..., me seli në P., përfaqësuar nga T.B-B av në P., kundër debitorit Xh.G me nr personal ..., me vendbanim në Rr.B... G...nr. Istog, për shkak të borxhit në shume prej 2500 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt: 04.10.2021 kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbartimit, gjykata jashtë seance me dt.20.01.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Xh.G me nr personal ..., me vendbanim në Rr.B... G...nr. Istog, ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbartim P.nr.855/2021 të dt.31.08.2021, sipas propozimit të kreditorit F.. SH.P.K me nr. te biznesit ..., me seli në P..

**A r s y e t i m**

Kreditori F.. SH.P.K me nr. te biznesit ..., me seli në P., ka ushtruar propozimin për përmbartim të përmbartuesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimi ndaj debitorit Xh.G me nr personal ..., me vendbanim në Rr.B... G...nr. Istog, si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 2500 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrorit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, si dhe të sekuestrohet, regjistrohen dhe shiten sendet e luajtshme dhe të pa luajtshme, dhe kreditori të fitoj të drejte e pengut në sendet e inventarizuara, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbartim të dt.30.08.2021.

Përmbartuesi privat me urdhrin përmbartimit P.nr.855/2021 të dt.31.08.2021, e ka lejuar propozimin për përmbartim në këtë çështje përmbartimore.

Debitori, Xh.G me nr personal ..., me vendbanim në Rr.B... G...nr. Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbarimor me arsyetimin se lejimi i përmbarimit është në kundërshtim me nenin 22 par.1.3 dhe 1.7 dhe në lidhje me nenin 71 të LPP-së, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të lartcekura pasi që dokumenti me të cilin është lejuar përmbarimi nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tiparet e përmbarueshmerisë, pasi që neni 22 par.1.3 nuk korrespondon me kontratën e noterisë, kjo dispozitë interpretohet në kuptim të nenit 3 dhe 4 të Ligjit të noterisë, po ashtu par.1.7 i nenit 22 është aplikuar gabimisht sepse kjo dispozitë aplikohet në kuptim të kontratave të pengut që janë të regjistruar në regjistrat publik, kurse kontrata për shitblerjen e automjetit është në mes palëve, që rrjedh nga transaksioni tregtar bazuar në parimet e të drejtës së detyrimeve dhe në qoftëse paraqiten probleme rreth përmbushjes si dhe nulitetit se pari inicohet procedurë kontestimore, përndryshe ky lloj dokumenti nuk është i ekzekutueshëm, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, të refuzohet urdhri përmbarimor dhe të anulohet propozimi për përmbarim. Shpenzimet për prapësim si dhe për taksat për përmbarim i kërkoj

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe me mundësin e parashtrimit të përgjigjes, ku me dt.25.10.2021, ka parashtruar përgjigje me arsyetimin se prapësimi i debitorit është i pa bazuar pasi që me rastin e lejimit të përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm kreditori i ka dorëzuar të gjitha faktet dhe provat në original, ashtu që lejimi i përmbarimit është bërë në bazë të aktit noterial, ku të gjitha aktet noteriale konform nenit 22 par.1.3 të LPP-së janë të përmbarueshme.

Me tutje kreditori shton se sipas nenit 8 të aktit noterial debitori ka qenë në dijeni se kjo kontratë ka titull, ekzekutiv dhe se përmbaruesi do të caktoj përmbarimin vetëm në bazë të këtij titulli, andaj kërkojmë që të refuzohet si i bazuar prapësimi, të detyrohet pagesa e shpenzimeve të procedurës si dhe të paguaj komtën 8% nga dita kur fatura është bërë e arritshme e deri në përmbarimin e saj.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se lejimi i përmbarimit është në kundërshtim me nenin 22 par.1.3 dhe 1.7 dhe në lidhje me nenin 71 të LPP-së pasi që dokumenti me të cilin është lejuar përmbarimi nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tiparet e përmbarueshmerisë, pasi që neni 22 par.1.3 nuk korrespondon me kontratën e noterisë, kjo dispozitë interpretohet në kuptim të nenit 3 dhe 4 të Ligjit të noterisë, po ashtu par.1.7 i nenit 22 është aplikuar gabimisht sepse kjo dispozitë aplikohet në kuptim të kontratave të pengut që

janë te regjistruar ne regjistrat publik, pretendimet e lartcekura gjykata i refuzoj si te pa bazuara pasi qe lejimi i përmbarimit është bërë ne bazë te Kontratës mbi shitblerjen e automjetit, ku në nenin tetë të së njëjtës kontratë në mënyrë shprehimore është paraparë dhe palët janë pajtuar qe e njëjta kontratë paraqet titull ekzekutiv, e duke u bazuar ne nenin 22 par.1 nenpar.1.3 ne mënyrë shprehimore ka paraparë qe cilësinë e dokumentit përmbarimor e ka edhe dokumenti noterial i pambarueshëm ne pajtim me ligjin e noterisë, andaj lejimi përmbarimit është bërë konform dispozitës se lartcekur e ne lidhje me nenin 21, 26, 36 dhe 38 te LPP-së.

Po ashtu ne bazë te nenit 3 par.2.2 dhe par.3 te Ligjit te noterisë ku parashihet se “Dokumentet noteriale të lëshuara sipas këtij ligji kanë fuqinë e dokumenteve publike, nëse me rastin e hartimit dhe lëshimit të tyre janë plotësuar formalitetet themelore të parapara me ligj. Dokumenti noterial ka fuqinë provuese dhe është dokument përmbarimor në rastet e parapara me ligj”, andaj kontrata me te cilën është lejuar përmbarimi i plotëson te gjitha kushtet ligjore dhe është dokument i përshtatshëm për përmbarim.

Për me tepër me nënshkrimin e kontratës kanë lindur te drejta dhe detyrime ne mes kreditorit dhe debitorit, ku kreditori ka pasur për obligim dorëzimin e sendit-veturës, kurse debitori ta paguaj shumen si ne kontratë, dhe me rastin e mos kryerjes se detyrave secila nga dy palët ka pasur te drejt te inicioj procedurën qe të obligohet pala tjetër ne përmbushjen e detyrimit andaj duke u bazuar ne 245 te LMD-së debitori i obligohet pagesën e borxhit kreditori si ne propozim, ku par.1 i nenit te lartcekur parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjithashtu neni 249 par.1 te LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t`i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t`i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Lidhur me kamatën e aplikuar gjykata veproj konform nenit 382 par.1 dhe 2 te LMD-së

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së dhe te Ligjit te Noterisë.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 21, 22 par.1.3, 26, 38, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 249 par.1 dhe 2 dhe 382 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në lidhje me nenin 3 par.2.2 dhe par.3 të Ligjit të Noterisë, e lidhur me nenin 8 të Kontratës mbi shitblerjen e automjetit e dt. 27.07.2021, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.47/2021, dt.20.01.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në P., e përmes kësaj gjykate